



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 298, Datë 19.10.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SH.P.K. PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI MJET (BARRË
SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 8 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2056/7 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.03.2023, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga central fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në zonën e Povelçës, Bashkia Fier.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2056 prot., datë 22.08.2023, shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k. paraqiti kërkesën për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj “INTESA SAN PAOLO BANK” sh.a. në kuadër të veprimeve të nevojshme për një implementim të suksesshëm të projektit, duke rënë dakord me “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” sh.a. që ta financojë projektin nëpërmjet një kredie bankare, për garantimin e së cilës është kërkuar ndër të tjera dhe vendosja e barrës siguruese mbi kuotat e shoqërisë.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2056/2 prot., datë 07.09.2023, duke i evidentuar dokumentacionin e konstatuar që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim. Shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2056/3 prot., datë 14.09.2023 dhe nr. 2056/6 prot., datë 06.10.2023 depozitoi dokumentacion plotësues për këtë aplikim.
- Shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k., ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.
- Shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Kontrata nr. 2772 Rep., nr. 875 Kol., datë 23.09.2022, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k.”, e nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k., nuk përmban detyrimin për miratimin/njoftimin e autoritetit shtetëror për shoqërinë, por si dhe në raste analoge dhe në zbatim të nenit 8, gërmës “e” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.
- Shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k. duhet të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguruese mbi kuotat e saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj “INTESA SAN PAOLO BANK ALBANIA” sh.a.
2. Dhënia e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e

organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k. të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjen e barrës siguroese mbi kuotat e saj.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në zbatim të pikave 2 dhe 3.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI